

KËRKESË E IPN RQ 12/01

12 prill 2012

LAJMËRIM REGJISTRIMI

**Lënda: Kërkesë për Inspektim
Republika e Kosovës: Projekti Energjitik i Kosovës (i propozuar)**

Më 29 mars 2012 Inspektoriati ("Inspektoriati") mori një Kërkesë për Inspektim ("Kërkesa") në lidhje me dy Projekte, përkatësisht Projekti Energjitik i Kosovës (PEK, i propozuar) dhe Projekti i Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti (PATEL, i mbyllur).

Kërkesa ishte dërguar nga përfaqësuesit e banorëve të fshatrave Darshishtë, Lajthishtë/Sibofc, Cerna Vidoca dhe Hade të Bashkisë Obiliq dhe qytetit Obiliq në Kosovë, Sindikata e Pavarur e Energjistikës së Kosovës në Korporatën Energjitike të Kosovës dhe tre organizata kosovare të shoqërisë civile, përkatësisht Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), Instituti i Studimeve të Avancuara, dhe Forumi për Iniciativën Civile ("Kërkuesit"). Kërkesa shoqërohej nga 14 anekse, ku përfshihej një aneks me kopje komunikimesh me Bankën Botërore, një aneks me hollësi teknike, dhe një Letër Përfaqësimi nëpërmjet të cilës autorizohet Z. Nezir Sinani i Institutit për Politika Zhvillimore në Kosovë (INDEP) që të përfaqësonte Kërkuesit në procesin e zhvilluar nga Inspektoriati.

Kërkuesit deklarojnë se janë "të shqetësuar në lidhje me efektet shumë serioze sociale, ekonomike dhe mjedisore që lidhen me PEK dhe PATEL" dhe se ata "i kanë ndjerë tashmë efektet e këtyre projekteve dhe janë të shqetësuar se çfarë do të ndodhë mbas përfundimit të ndërtimit të PEK".

Projekti

Dokumenti i Informacionit mbi Projektin (DIP) për Projektin e propozuar Energjitik të Kosovës thotë se Qeveria e Kosovës (QeK) ka "kërkuar që Banka Botërore të sigurojë mbështetje në formën e një garancie të pjesshme rreziku nga IDA për një projekt të propozuar energjitik që do të përdorë linjite të vendit". "Objektivi i çdo mbështetjeje financiare nga ana e Bankës Botërore për Projektin e propozuar Energjitik në Kosovë do të ishte reduktimi i efekteve mjedisore të prodhimit të energjisë elektrike dhe forcimi i sigurisë së furnizimit me energji në Kosovë në mënyrë ekonomikisht efikase, ambjentalisht të qëndrueshme dhe pa karbon".¹

Kostoja totale e Projektit të propozuar Energjitik në Kosovë (PEK) është parashikuar në shumën prej 2 miliardë dollarë, nga të cilat 50 milion dollarë ka mundësi të

¹ Dokumenti i Informacionit mbi Projektin (DIP), Projekti Energjitik i Kosovës, 27 korrik 2011, Banka Botërore.

kërkohen si garanci e pjeshme rreziku nga IDA. Projekti ëshë kategorizuar si Kategori Mjedisore “A” dhe ëshëtë propozuar të implementohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Kosovës.²

PEK i propozuar “*parashikonte zëvendësimin e Termocentralit Kosova A me një termocentral ekzistues të rehabilituar (Kosova B) dhe një termocentral të ri si dhe hapjen e një miniere për të përmbushur nevojat për lëndë djegëse*”. “*Termocentrali i ri i propozuar me fuqi 600 MW do të ndërtohej si një zgjerim i termocentralit Kosova B dhe do të kishte disa objekte të përbashkëta me të. Në varësi të një përcaktimi më të qartë të synimit të projektit, infrastruktura shoqëruese që do të mund të nevojitej në perspektivë do të përfshinte një përmirësim të rrjetit elektrik, një rezervuar amortizator uji, një fushë (deponi) të përshatshme për depozitimin (deponimin) e hirit, si dhe infrastrukturë tjetër shoqëruese të mundshme, si për shembull përmirësimet e nevojshme të kanalit ujq Iber-Lepenc.*”³

Në korrik 2011 Banka Botërore krijoi një Grup Ekspertësh të Jashtëm për të marrë në shqyrtim përputhjen e PEK të propozuar me gjashtë kriteret e Bankës Botërore për mbështetjen e projekteve të prodhimit të elektricitetit me lëndë djegëse qymuri. Vendimi i Bankës nëse do të jepte ose jo mbështetje financiare për PEK do të varej nga konkluzionet e shqyrtimit të kryer nga Grupi i Ekspertëve. Grupi i Ekspertëve e dorëzoi raportin e tij në 31 janar 2012, dhe konkludonte se sipas mendimit të ekspertëve, projekti përputhej me të gjashta kriteret e Bankës Botërore për mbështetjen e projekteve të prodhimit të elektricitetit me lëndë djegëse qymuri.⁴

Sipas dokumentave të projektit, përgatitja e PEK të propozuar është mbështetur nga Projekti i Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti (PATEL) nëpërmjet të cilit u financuan “disa aktivitete kyç”, ku përfshiheshin përgatitja e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS), përgatitja e Planit të Veprimit të Shvendosjes për fshatin Hade, dhe blerja e paisjeve të monitorimit të ajrit.⁵ PATEL u mbështet nga dy grante për asistencë teknike prej rreth 8.5 milion dollarë. U aprovua nga Bordi në 12 tetor 2006 dhe u mbyll në 31 dhjetor 2011. PATEL u klasifikua si Kategori “B” që kërkonte OP/BP 4.01 (Vlerësim Mjedisor) “*për arsye të efekteve të masave mbrojtëse të projekteve të mundshme ndjekëse për investime, mundësia për sukses e të cilave u studiua në kuadrin e PATEL*”.⁶

PATEL financoi kryesisht përgatitjen e legjislacionit kyç dhe amendamenteve të tij për të lehtësuar transaksionin e propozuar të Minierës së Re/termocentralit, ku përfshiheshin një “*projekt-rregullorë e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS), dhe përgatitja e Kuadrit Politik të Zhvendosjes në përputhje me OP/BP 4.12 të Bankës*

² Profil Projekti, Projekti Energjitik i Kosovës, faqja e jashtme e internetit e Bankës Botërore <http://www.worldbank.org/projects/P118287/kosovo-power-project?lang=en> (informacioni i azhurnuar në 12 prill 2012).

³ Fletë të Dhënash mbi Masat Mbrojtëse të Integruara (FDMMI), Faza e Konceptimit, Projekti Energjitik i Kosovës, 27 korrik 2011, Banka Botërore.

⁴ Kosovë: Projekti Energjitik i Kosovës, Raport i Grupit të Jashtëm të Ekspertëve të Bankës Botërore për SFDC, janar 2012.

⁵ FDMMI, Faza e Konceptimit, Projekti Energjitik i Kosovës 27 korrik 2011.

⁶ Dokumenti i Vlerësimit të Projektit, Projekti i Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti, Kosovë, 13 shtator 2006, Banka Botërore, faqe iii.

Botërore mbi Zhvendosjen Jo-Vullnetare si dhe një projekt-legjislacion mbi shpronësimin e tokave dhe zhvendosjen”, përgatitjen e dokumentave ligjore dhe kontraktuale për një paketë tenderimi, përgatitjen e një Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS) specifik për zhvillimin e sektorit energjistik, përgatitjen e mjeteve bazë të monitorimit mjedisor, dhe një plani për forcim institucional dhe zhvillim kapacitetesh. PATEL financoi gjithashtu një Shqyrtim të Alternativave për Investim, Analizën Teknike për Ndërtimin e Termocentralit të Ri, si dhe masat për Energji të Ripërtëritshme, Bashkëprodhim dhe Efikasitet Energjistik, si dhe mbështeti krijimin e kapaciteteve për ministrinë dhe agjencitë kryesore. PATEL mbështeti gjithashtu edhe një proces kompetitiv transaksioni i cili synonte të përzgjidhte një tenderues të suksesshëm për ndërtimin e Minierës së Re/termocentralit të propozuar.⁷

Grupi vë re se grantet e IDA për PATEL u mbyllën në 31 dhjetor 2011 dhe në përputhje me Paragrafin 14 (c) të Rezolutës⁸ që krijoi Inspektoriatin (“Rezoluta”), PATEL nuk mbulohet nga ky regjistrim.⁹ Grupi vë re gjithashtu se pavarësisht nga burimi i financimit, studimet e kryera në mbështetje të përgatitjes së PEK do t’i nënshtroheshin procesit të Inspektoriatit në të ardhmen.

Kërkesa

Kërkesa ngre disa shqetësime sociale, ekonomike dhe mjedisore si dhe probleme të mospërputhjes me politikën dhe procedurat e Bankës. Shqetësimet e Kërkuesve, të paraqitura në Kërkesën për Inspektim, janë diskutuar më poshtë.

Ndotja e Ambjentit. Kërkuesit shprehen se PEK është planifikuar të ndërtohet në bashkinë Obiliq ku për momentin operojnë termocentralet Kosova A dhe Kosova B dhe se “përdorimi i linjitet për nevojat e të dy termocentraleve ekzistuese dhe trajtimi teknologjik në këtë zonë e kanë kthyer Obiliqin dhe fshatrat përreth të në zonën më të ndotur në Europë”. Ata shprehen se ndotja në këtë zonë është “e gjithanshme” dhe se “pasoja e djegjes së qymyrit si lëndë djegëse për prodhimin e elektricitetit ndikon në mënyrë direkte mbi jetën tonë dhe të 500.000 banorëve të kryeqytetit” Prishtinë i cili është vetëm 7 km larg nga termocentralet, dhe se përdorimi në rritje i linjitet nga termocentrali i ri i propozuar do t’a keqësonte situatën për banorët e Obiliqit dhe fshatrave përreth tij.

Për më tepër, Kërkuesit shprehen se ndotja nga djegia e qymyrit që rezulton në “lëshimin e tymit, dioksid sulfurik, hekur, zink, mërkur dhe ndotës të tjerë, ndikon drejtpërdrejt në rritjen e rasteve të sëmundjeve kardio-vaskulare dhe nervore në radhët e komuniteteve”, dhe se fëmijët e tyre janë “veçanërisht të ndikueshëm dhe se aftësitë e tyre njohëse do të ndikohen nga lëshimi i mërkurit dhe hekurit në ambjent, ndërkohë që kloruri i hidrogjenit do të ndikojë në mushkëritë e tyre.”

⁷ PAD, PATEL, f. 9-10.

⁸ Shoqata për Zhvillim Ndërkombëtar, Rezoluta Nr. IDA 93-6, e datës 22 shtator 1993 (“Rezoluta”)

⁹ Paragrafi 14 (c) i Rezolutës mbi Inspektoriatin parashikon që Inspektoriati nuk merr në konsideratë “Kërkesat e paraqitura mbas Datës së Mbylljes së huasë që financon projektin në lidhje me të cilën është paraqitur kërkesa, apo mbasi është bërë disbursimi pothuaj i plotë i huasë që financon projektin”. Disbursim konsiderohet pothuaj i plotë kur është disbursuar të paktën 95% e shumës së huasë.

Kërkuesit mendojnë se “*efekti më i madh*” është ndotja e ujit për arsye se lumi dhe ujrat nëntokësore janë të ndotura nga “*hiri i linjtit, hiri në ajër dhe ndotës të tjera nga shkarkimet e linjtit*”. Ata shprehen gjithashtu se meqë “*60% e komuniteteve që jetojnë në zonën e ndotur janë fermerë, ndotja ndikon gjithashtu edhe mbi tufat tona të bagëtive, për arsye se ato përdorin lumin dhe ujrat nëntokësore ...*” dhe se shëndeti i njerëzve ndikohet në këtë mënyrë nëpërmjet konsumimit të produkteve shtazore.

Aneksi Teknik i bashkangjitur Kërkesës jep hollësira të mëtejshme mbi shqetësimet e Kërkuesve dhe ngre disa pyetje në lidhje me mjaftueshmërinë e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS). Në mënyrë më specifike, në Aneksin Teknik thuhet se meqë Bank nuk e ka bërë të qartë nëse VSMS do të shërbejë si Vlerësim Mjedisor për PEK të propozuar, mund të prezumohet se kjo është analiza e vetme e përgatitur që përputhet me kërkesat e OP 4.01 (Vlerësimi Mjedisor). Për më tepër, aty thuhet se VSMS nuk përputhet me kërkesat e OP 4.01 që kanë të bëjnë me efektet mjedisore, shëndetësore dhe sociale, konsiderimin e alternativave dhe konsultimet me komunitetet e ndikuara.¹⁰

Mungesa e Ujit. Kërkuesit shprehen se PEK parashikon që uji nga Kanali Iber Lepenc, i cili përdoret për të përmbushur kërkesat e ujitjes për 3 bashki dhe siguron ujë të pijshëm për Prishtinën dhe rrethinat e saj, të përdoret për të furnizuar PEK dhe dy termocentralet ekzistuese. Ata shprehin shqetësim se kjo do të sjellë mungesa në ujitje dhe si rrjedhim do të ndikojë mbi prodhimin bujqësor dhe do të keqësojë mungesat ekzistuese të ujit në Prishtinë. Ata shprehen se kanë nevojë për ujë për shtëpitë dhe fermat e tyre dhe se me ndërtimin e PEK nuk do të ketë ujë për ta.

Ndikimi Ekonomik. Kërkuesit shprehen se gjatë shtatë vjetëve të fundit, 70% e zonës së bashkisë Obiliq është deklaruar “*zone me interes kombëtar*” për arsye të minierës së linjtit. Ky deklaram solli si pasojë që banorët e zonës të mos kenë “*të drejtë të përmirësojnë shtëpitë e tyre*” apo të ndërtojnë shtëpi të reja. Për më tepër, ata shprehen se fshatrat Hade, Dardhishtë dhe Lajthishtë nuk u përfshinë në ndonjë plan kompensimi për ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës. Ata shprehen gjithashtu se vuajnë nga “*mungesa sistematike elektriciteti*” të cilat “*rrisin rrezikun e aksidenteve për popullsinë që jeton pothuaj në “oborrin” e termocentralit dhe minierës ekzistuese.*”

Ndikimi mbi Punësimin. Kërkuesit shprehen se “*qindra*” punonjës të Korporatës Energjitike do të pushohen si rezultat i PEK për arsye se termocentrali Kosova A do të mbyllet brenda vitit 2017 dhe funksioni i furnizimit dhe shpërndarjes do të privatizohet. Ata shprehen se nuk u mor mendimi i Sindikatës së Punonjësve të KEK (SPEK) në lidhje me ndikimet mbi punësimin dhe se Banka Botërore “*ka për detyrim që nëpërmjet praktikave më të mira të punës të marrë masa specifike në drejtim të punonjësve që ndikohen nga procesi i implementimit të PEK. Krijimi i paketave stimuluese për këta punonjës nuk shihet askund në horizont, ndërkohë që BB nuk ka përfshirë në këtë projekt investime në fushat e tjera të zhvillimit energjistik në Kosovë.*”

¹⁰ Aneks Teknik bashkangjitur Kërkesës për Inspektim të Projektit të propozuar Energjistik të Kosovës, 29 mars 2012, f. 9-10.

Ata shprehen gjithashtu se “Kosova aktualisht humb rreth 40% të elektricitetit të prodhuar dhe të importuar si rezultat i humbjeve teknike dhe tregtare në rrjet, ndërkohë që kërkesa për energji elektrike është 30% më e lartë si rezultat i këtyre humbjeve dhe si rezultat i mungesës së projekteve për efikasitet energjistik dhe izolim të përshtatshëm të shtëpive.” Ata shprehen se zhvillimi i projekteve për zvogëlimin e humbjeve në energji elektrike dhe promovimin e efikasitetit energjistik “do të rezultonte në rritjen e numrit të punonjësve dhe sipas tendencave aktuale ndërkombëtare, rritja e numrit të vendeve të punës në këtë fushë është shumë më lart se sa investimi në termocentralin e ri.”

Zhvendosja. Kërkuesit shprehen se zhvendosja e “banorëve të Hades për PEK” filloi në kuadrin e PATEL pa “hartuar ndonjë plan pune për zhvendosjen e banorëve dhe pa ndonjë politikë kombëtare për zhvendosje që të përputhej me politikën e Bankës Botërore mbi zhvendosjen.” Ata shprehen se zhvendosja u krye në kundërshtim me “këto politika dhe bëri që kompensimi i paguar për banorët e këtyre fshatrave për zhvendosjen të ishte i padrejtë dhe i paktë.”

Ata shprehen gjithashtu se zhvendosja që mund të ndodhë si rezultat i hapjes së një miniere dhe ndërtimit të termocentralit të ri duhet të bëhet në përputhje me politikën kombëtare të zhvendosjes të cilat “parashikojnë që ne dhe komshijtë tanë në Obiliq të zhvendosemi brenda territorit të Obiliqit”. Megjithatë, ata shprehen se meqë 70% e territorit të Obiliqit është deklaruar si zonë me interes kombëtar, kjo do të krijojë një “problem serioz për procesin e zhvendosjes” për arsye se “pengon zhvendosjen e përshtatshme në bazë të politikave të Bankës Botërore mbi zhvendosjen.” Për më tepër, ata shprehen se “zhvendosja duhet të kryhet në përputhje me këto politika” dhe se çdo zhvendosje në të ardhmen do të “kërkojë rishikim të politikave aktuale të zhvendosjes”.

Mungesa e transparencës dhe konsultimeve. Kërkuesit shprehen se “komuniteti i Obiliqit, Sindikata e Punonjësve të KEK dhe shoqëria civile janë përjashtuar nga procesi i vendim marrjes” që nga momenti që Banka Botërore u përfshi në projektet energjitike në vend dhe se “kërkesat për dokumentacion zyrtar, që parashikohet në legjislacionin kombëtar, janë refuzuar në mënyrë konstante nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, agjencia që drejton projektin; e po ashtu edhe nga Banka Botërore pothuaj në të gjitha rastet.” Mungesa e informacionit, sipas mendimit të tyre, i ka privuar ata nga “e drejta për t’u përfshirë në këto projekte” dhe bie “në kundërshtim me politikën e Bankës Botërore mbi të drejtën e informimit dhe përhapjen e informacionit.”

Kërkuesit shprehen gjithashtu se ata do t’i “referohen përsëri të gjitha kërkesave të paraqitura tek Banka Botërore dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik për marrjen e informacionit në lidhje me PATEL dhe PEK”, të cilat janë paraqitur “kryesisht nga Z. Nezir Sinani në emër të shoqërisë civile dhe komunitetit të Obiliqit dhe fshatrave përreth.”

Mungesa e studimeve mbi burimet alternative të energjisë. Kërkuesit shprehen se shoqëria civile në Kosovë i ka kërkuar Bankës Botërore një analizë të plotë të alternativave energjitike të Kosovës dhe një analizë ekonomike por “Banka Botërore akoma nuk ka një ide të plotë të faktit se çfare ofron Kosova përsa i përket burimeve alternative të energjisë.” Ata i referohen analizës së kryer nga shoqëria civile dhe Universiteti i Kalifornisë, Berkli, i cili “tregon se Kosova ka potencial të madh burimesh alternative dhe se ky potencial është ekonomikisht i mundshëm, i shërben qëllimit të mbrotjes së shëndetit

dhe ambjentit në Kosovë dhe krijon 30% më shumë vende pune.” Për me tepër, ata shprehen se po te marrim parasysh mungesën e një analize të tillë dhe mungesën e një “Partneriteti Strategjik faktik në Kosovë, Banka Botërore ka nisur angazhimin e saj në këtë projekt në një mënyrë që jo vetëm bie në kundërshtim me politikën e saj mbi këto projekte por bie në kundërshtim edhe me praktikën më të mira të punës të hartuara dhe aplikuar nga Banka.”

Kërkuesit shprehen se ata i kanë ngritur këto probleme me stafin përkatës të Bankës Botërore në shumë raste, dhe më së fundmi në një letër të datës 5 mars 2012 dhe nuk janë të kënaqur me përgjigjen e marrë. Siç thuhet më sipër, Kërkuesi ka bashkangjitur një aneks me kopje të komunikimeve me Bankën Botërore.

Kërkuesit i kërkojnë Bordit të Bankës Botërore që *“t’iu përgjigjet menjëherë të gjitha kërkesave dhe shqetësimeve të ngritura në lidhje me projektet në fjalë.”*

Deklarimet e mësipërme mund të përbëjnë, ndër të tjera, mospërputhje të Bankës me dispozitatë të ndryshme të Politikave dhe Proçedurave Operative si më poshtë:

OP/BP 4.01	Vlerësimi Mjedisor
OP/BP 4.12	Zhvendosja Jo-Vullnetare
OP/BP 10.04	Vlerësimi Ekonomik
OMS 2.20	Vlerësimi i Projekti

Inspektoriati vë re se në gusht 2011 Zyra e Këshilltarit të Përmbushjes/Avokatit të Popullit (CAO) e Korporatës Ndërkombëtare të Financës (IFC) mori një ankesë në lidhje me Projektin e KEK Kosovë të financuar nga IFC (#29107).¹¹ Projekti i IFC siguronte asistencë për QeK në privatizimin e funksioneve të KEK për shpërndarjen (distribucionin) e energjisë. Shqetësimet e ngritura në ankesën e marrë nga CAO kanë të bëjnë me ndikimet sociale dhe mjedisore të privatizimit të KEK, mundësinë e marrjes së informacionit dhe mungesën e një Vlerësimi të përshtatshëm Social dhe Mjedisor.

Në përputhje me paragrafin 17 të Proçedurave Operative të Inspektoriatit (“Proçedurat Operative”), po ju njoftoj se në datën 12 prill 2012, që është dhe data e nisjes së këtij njoftimi, unë e kam regjistruar këtë Kërkesë në Regjistrin e Inspektoriatit. Ju lutem vini re se regjistrimi i Inspektoriatit është një proçedurë administrative dhe nuk nënkupton marrjen e ndonjë vendimi në lidhje me meritat e Kërkesës për Inspektim

Sipas dispozitave të paragrafit 18 të Rezolutës së IDA, në bazë të të cilit krijohet Inspektoriati, paragrafet 2 dhe 8 të *“Konkluzioneve të Bordit në Shqyrtimin e Dytë të Inspektoriatit”* (“Sqarimi i Vitit 1999”) dhe paragrafi 18(d) i Proçedurave Operative, Ekipi Menaxhues i Bankës duhet t’i paraqesë Inspektoriatit, brenda datës 11 maj 2012, prova dokumentore me shkrim se ka vepruar, apo ka ndër mend të veprojë, në përputhje me politikën dhe proçedurat përkatëse të Bankës në lidhje me Projektin e sipër-përmendur. Çështja që shtrihet përpara Ekipit Menaxhues në përgjigjen e tij ndaj Kërkesës parashtrihet në paragrafet 3 dhe 4 të Sqarimit të Vitit 1999.

¹¹ Faqja e internetit e Zyrës së Këshilltarit të Përmbushjes/Avokatit të Popullit në IFC përmban informacion të mëtejshëm në lidhje me ankesën e marrë tek adresa: http://www.cao-ombudsman.org/documents/Kosovo_webtext_English_January2012.pdf

Mbas marrjes së përgjigjes nga Ekipi Menaxhues, Inspektoriati në përputhje me Sqarimin e Vitit 1999 dhe dispozitat e paragrafit 19 të Rezolutës, “do të përcaktojë nëse Kërkesa përmbush kriteret e kualifikimit të përcaktuara në paragrafet 12 dhe 14 [te Rezolutës] dhe do t’i paraqesë Drejtorëve Ekzekutivë rekomandimet e tij nëse kjo çështje duhet hetuar.”

Të gjitha komunikimet me Kërkuesit në lidhje me Kërkesën do t’i dërgohen Z. Nezir Sinani, punonjës i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP).

Kërkesës i është caktuar ky numër: Numër Kërkese i IPN RQ 12/01.

Me respekt,

Alf Morten Jerve
Kryetar

Nezir Sinani
Hulumtues/Analist i Lartë
Institutit për Politika Zhvillimore,
Rr. Rrustem Statovci Nr. 78
10000 Prishtinë, Kosovë
Email: nezir.sinani@indep.info

Z. Robert B. Zoellick
President
Shoqata E Zhvillimit Ndërkombëtar

Drejtorët Ekzekutive dhe Alternativë
Shoqata E Zhvillimit Ndërkombëtar